VENDIM
Nr. 80, datë 31.5.2019

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "ENERGY24" SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa "e"; nenit 5, pika 1, germa "e"; nenit 13, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 15 të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 31.5.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut, lidhur me "Licencimin e shoqërisë "Energy 24" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 61, datë 19.4.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë "Energy24" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- ERE me shkresën nr. 32/17 prot., datë 18.4.2019, ka publikuar njoftimin në median e shkruar lidhur me vendimin nr. 61, datë 19.4.2019 mbi "Fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "Energy24" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike".

-ERE në shkresën nr. 273/1 Prot., datë 2.5.2019 ka përcjellë pranë subjektit "Energy24" sh.p.k., njoftimin e vendimit të fillimit të procedurës dhe kërkesën për plotësimin e dokumentacionit të munguar.

-Me shkresën me nr. 273/2 prot. hyrës, datë 14.5.2019 shoqëria "Energy 24" sh.p.k. ka përcjellë pranë ERE-s, dokumentacionin e munguar sikurse është kërkuar nga ERE.

- Në përfundim të afatit të përcaktuar në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike" të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, nuk rezultoi të ketë ndonjë vërejtje apo ankesë nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria "Energy 24" sh.p.k., për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

- Nga analiza që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria "Energy 24" sh.p.k., në bazë të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", rezulton se subjekti ka plotësuar tërësisht kërkesat, si më poshtë:

- Neni 9, pika 1, germat "a", "b" dhe "c" – formati dhe dokumentacioni për aplikim, është plotësuar.

- Neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c" "d" dhe "e" – dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, është plotësuar.

- Neni 9, pika 3, germat "a", "b", "c" dhe "d" – dokumentacioni financiar dhe fiskal, është plotësuar.

- Neni 9, pika 4.8, germat "a", "b", "c" dhe "d" – dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, është plotësuar.

-

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Energy24" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETAR
Petrit Ahmeti